



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 142, datë 18.06.2020

PËR CAKTIM TË PËRKOHSHËM

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164/8, 166/2, 189/1/a të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” miratuar me Vendimin nr. 64, datë 15.04.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

V E N D O S I:

1. **Z. Abaz Muça**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat.
2. Z. Abaz Muça do të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat, përkohësisht nga data 19.06.2020 - 18.09.2020.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, Z. Abaz Muça do të paguhet me pagën e pozicionit të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat.
4. Të njoftohen me këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Z. Abaz Muça dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETARI
GENT IBRAHIMI

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
NURIHAN SEFI

ANËTAR
TARTAR BAZAJ